



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E GJILANIT  
MUNICIPALITY GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



---

**DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK**  
DEPARTMENT OF ECONOMY DEVELOPMENT – UPRAVA ZA EKONOMSKI RAZVOJ - İKTİSADI KALKINMA MDÜRLÜĞÜ

---

**RREGULLORE PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË  
PUNËS TË SUBJEKTEVE AFARISTE NË TERRITORIN E  
KOMUNËS SË GJILANIT**

*Gjilan, shkurt 2024*

---

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja c), nenit 17 shkronja s) , neni 40 paragrafi 40.2 shkronja a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (GZ e RK nr.28/2008 të dt.04 Qershor 2008), nenit 40 paragrafi 40.1 të Ligjit Nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme (GZ e IPVQ nr.17 e dt.01 Tetor 2007), Ligji Nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.5 dt.21 korrik 2011) dhe nenit X paragrafi X të Statutit XXX të Komunës së Gjilanit Nr.XXXX i dt.XXXX, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më XXXXX, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS TË SUBJEKTEVE AFARISTE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GJILANIT**

Nr. XX/2024

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo rregullore ka qëllim PËRCAKTIMIN E ORARIT TË PUNËS në lëmin e tregtisë dhe të aktiviteteve tjera për të gjitha shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtarin e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Gjilanit.

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

Organizatat e biznesit, në pajtim me nenin 1 të kësaj Rregulloreje, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore | Dispozitat e kësaj rregullore janë të obligueshme për të gjithë personat juridik dhe fizik që ushtrojnë veprimtarin e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Gjilanit,

#### **Neni 3 Përkufizimet**

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore, kanë kuptim si në vijim:

**3.1 Lokal afarist** – nënkupton objektin apo hapësirën punuese ku ushtrohet veprimtaria.

**3.2 Person** - nënkupton personin juridik dhe fizik

**3.3 Person fizik** – nënkupton personin fizik jo afaristë që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi dhe personi fizik afarist që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe zhvillojnë aktivitet të rregullta afarist!

**3.4 Person juridik** – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare | dhe çdo legjislacion tjerë të aplikueshme në Kosovë:

**3.5 Shoqëritë tregtare** – nënkupton termin e përgjithshëm që përfshinë çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovës sipas Ligjit për shoqëritë tregtare apo ndonjë ligji tjetër, duke përfshirë bizneset individual, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuar, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare

**3.6 Inspektori** – nënkupton personi zyrtar me autorizim dhe përgjegjësi të veçanta i cili zbaton mbikëqyrjen inspektuese të afarizmit të subjektit ekonomik.

**3.7 Periudha verore** – nënkupton periudhën e vitit nga data 21 Mars deri 20 Tetor

**3.8 Periudha dimërore** – nënkupton periudhën e vitit nga data 21 Tetor deri 20 Mars

**3.9 Vikend** – nënkupton ditët e fundjavës, dita e shtunë dhe e diele.

**3.10 Festat zyrtare** – nënkupton ditët e festave, sipas Ligjit Nr. 03/L-64 për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**3.11 DZHE** – nënkupton Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik

**3.12 DI** – nënkupton Drejtorinë për Inspektion

## **Neni 4**

### **Përmbajtja e orarit të punës nga veprimtarit ekonomike**

4.1 Orari i punës nënkupton periudhën kohore – fillimin dhe mbarimin e punës.

4.2 Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, si dhe pauza ditore e përcaktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria e biznesit. Në orar të punës duhet cekur ditët kur nuk punohet.

4.3 Me këtë rregullore përcaktohet orari i punës për subjektet afariste gjatë festave zyrtare.

4.4 Me këtë rregullore përcaktohen masat ndëshkimore për subjektet afariste që veprojnë në Komunën e Gjilanit.

## II. ORARI I PUNËS

Orari i punës përcaktohet në bazë të llogaritjes kohës verore dhe dimërore,:

- Koha verore fillon me 21 Mars deri më 20 Tetor
- Koha dimërore fillon me 21 Tetor deri më 20 Mars

### Neni 5

## ORARI I PUNËS PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

### 5.1 DYQANE ZEJTARE dhe BERBERET orari i punës:

- a) Koha verore prej orës 08:00 – 21:00
- b) Koha dimërore prej orës 08:00 – 20:00

Veprimtaritë e përcaktuara me paragrafin 5.1 punojnë 6 ditë në javë / e diela është ditë pushimi

### 5.2 FAST FOOD, GJELLËTORE, QEBAPTORE, BYREKTORE orari i punës :

- a) Koha verore prej orës 06:00 – 24:00
- b) Koha dimërore prej orës 06:00 – 23:00

Veprimtaritë e përcaktuara me paragrafin 5.2 punojnë 7 ditë në javë!

### 5.3 FURRAT E BUKËS orari i punës :

- a) Koha verore dhe dimërore prej orës 03:00 – 23:00

Veprimtaria e përcaktuar me paragrafin 5.3 punon 7 ditë në javë.

### 5.4 SALLONET E ONDULIMIT, FLOKTOREVE DHE VEPRIMTARIVE të ngjashme orari i punës:

- a) Koha verore prej orës 05:00 – 21:00
- b) Koha dimërore prej orës 06:00 – 20:00

Veprimtaritë e përcaktuara me paragrafin 5.4 (punojnë 6 ditë në javë) / e diela është ditë pushimi

### **5.5 INTERNET CAFÉ , GAMING ZONE, SONY PLAY STATION orari i punës:**

- a) Koha verore prej orës 08:00 – 24:00
- b) Koha dimërore prej orës 08:00 – 23:00

Veprimtaritë e përcaktuara me paragrafin 5.5 (punojnë 6 ditë në javë) / e diela është ditë pushimi

### **5.6 BARNATORET orari i punës:**

- a) Koha verore dhe dimërore prej orës 07:00 – 24:00

Veprimtaritë e përcaktuara me paragrafin 5.6 (punojnë 6 ditë në javë) / e diela është ditë pushimi

Megjithatë së paku tri barnatore duhet të jenë 24 orë në harmoni me planin për kujdestari të cilin duhet ta hartojnë: Drejtoria për Shëndetësisë, Oda Farmaciste e Gjilanit në bashkëpunim me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe me Sektorin Farmaceutik Privat.

Orari i kujdestarisë duhet të vendoset në ueb-faqen e Komunës, shërbimin e emergjencës, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe në Qendrat e Mjekësisë Familjare që gjinden në Komunën e Gjilanit.

### **5.7 KLINIKAT PRIVATE, ORDINANCAT, PËRFSHIRË EDHE ATO STOMATOLOGJIKE, LABORATORËT, RADIOLOGËT orari i punës:**

- a) Koha verore prej orës 07:00 – 21:00
- b) Koha dimërore prej orës 07:00 – 20:00

Veprimtaritë e përcaktuara me paragrafin 5.7 (punojnë 6 ditë në javë) / e diela është ditë pushimi

Nga paragrafi 5.7 i këtij neni, Klinikat Private, Ordinancat, përfshirë edhe ato Stomatologjike, Laboratorët, Radiologët munden të punojnë deri në ora 24:00 dhe ditëve të diela, vetëm pasi që pajisen me leje pune nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

**5.8 INSTITUCIONET PRIVATE EDUKATIVO-ARSIMORE QË PËRFSHIJNË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE, QENDRAT PËR MËSIM PLOTËSUES, KURSET PROFESIONALE, SHKOLLAT DIGJITALE, AUTO-SHKOLLAT DHE AKTIVITET PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE orari i punës:**

- a) Koha verore prej orës 07:00 – 22:00
- b) Koha dimërore prej orës 07:00 – 21:00

Veprimtaria e përcaktuar me paragrafin 5.8 punon 6 ditë në javë | e diela është ditë pushimi.

**5.9 DYQANET E VOGLA TREGTARE NËPËR LAGJE QË TREGTOJNË MALLËRA USHQIMORE DHE HIGJENIKE ME PAKICË PËRFSHIRË EDHE KIOSQET orari i punës:**

- a) Koha verore prej orës 07:00 – 24:00
- b) Koha dimërore prej orës 07:00 – 23:00

Veprimtaria e përcaktuar me paragrafin 5.9 punon 7 ditë në javë.

**Neni 6  
VEPRIMTARIT EKONOMIKE FINANCIARE**

**6.1. BANKAT, MIKROBANKAT, KËMBIMORE, KOMPANI TË SIGURIMEVE SI DHE VEPRIMTARIT QË HYJNË NË KUADËR TË VEPRIMTARISË BANKARE, AVOKATET, PËRMBARUESIT, NOTERËT, KONTABILISTET DHE AUDITORËT PRIVAT orari i punës:**

- a) Koha verore prej 08:00 - 17:00
- b) Koha dimërore prej 08:00 - 17:00
- c) Ditën e Shtunë prej 09:00 – 13:00

Veprimtaria e përcaktuar me paragrafin 6.1 punon 6 ditë në javë | e diela është ditë pushimi.

**Neni 7**  
**VEPRIMTARIT EKONOMIKE SHËRBYESE**

**7.1 DYQANET E VOGLA QË TREGTOJNË ME TEKSTIL, KOZMETIKË, KËPUCË, ARTIKUJ PËR FËMIJË, ELEKTRIKË, ELEKTRONIKË, MOBI-SHOP, AUTO PJESË , SANITARI , SI DHE DYQANET E TIPIT MIKS** orari punës:

- a) Koha verore prej 08:00 - 22:00
- b) Koha dimërore prej 08:00 - 20:00

Veprimtaria e përcaktuar me paragrafin 7.1 punon 6 ditë në javë | e diela është ditë pushimi.

**7.2 DYQANET QË KRYEJNË SHËRBIMIN E AUTOLARJES DHE GOMISTERI** orari i punës:

- a) Koha verore prej orës 07:00 – 20:00
- b) Koha dimërore prej orës 08:00 – 18:00

**7.3 AUTOLARJET / VETË SHËRBYESE** që punojnë 24 orë, duhet të pajisen me leje pune nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

Veprimtaritë e përcaktuara me paragrafin 7.3 punojnë 7 ditë në javë.

**7.4 AUTO PARKINGJET** orari i punës:

- a) Koha verore prej orës 07:00 – 24:00
- b) Koha dimërore prej orës 08:00 – 24:00

Veprimtaritë e përcaktuara me paragrafin 7.4 (punojnë 7 ditë në javë)

**7.5 AUTO BARTJET-ASISTENCË RRUGORE** orari i punës:

- a) Koha verore dhe dimërore - 24/7 gjatë tërë vitit.

**7.6 POMPAT E DERIVATEVE,** orari i punës:

- a) Koha verore dhe dimërore - 24/7 gjatë tërë vitit.

**7.7 AUTOMEKANIK, REGLAZHE, AUTO-ELEKTRICIST, SI DHE SHËRBIME TË TJERA (Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve) , orari i punës :**

- a) Koha verore prej orës 07:00 – 21:00
- b) Koha dimërore prej orës 08:00 – 20:00

Veprimtaritë e përcaktuara me paragrafin 7.5 punojnë 6 ditë në javë | e diela është ditë pushimi.

**7.8 QENDRAT E KONTROLLIT TEKNIK orari i punës :**

- a) Koha verore prej orës 08:00 – 16:00
- b) Koha dimërore prej orës 08:00 – 16:00

Veprimtaria e përcaktuar me paragrafin 7.7 punon 5 ditë në javë | e diela dhe dita e shtune janë ditë pushimi.

**Neni 8**

**VEPRIMTARIT EKONOMIKE TË TREGTISË ME PAKICË DHE SHUMICË**

**8.1 SUPERMARKETE, VETËSHËRBIME, QENDRA TREGTARE, KONCEPTET E TIPIT TE KOMBINUAR, RRJETET TREGTARE, DYQANET E SPECIALIZUAR PËR TEKNIKË DHE TEKSTIL orari i punës :**

- a) Koha verore prej orës 07:00 – 23:00
- b) Koha dimërore prej orës 07:00 – 22:00

Veprimtaria e përcaktuar me paragrafin 8.1 punojnë 6 ditë në javë | e diela ditë pushimi.

Veprimtaritë e përcaktuara nga Nenin 8, paragrafi 8.1, si Qendrat Tregtare, Supermarketet, Vetëshërbimet, mund të punojnë Ditën e Diele dhe diteve të tjera si dhe gjatë festave zyrtare me orar të zgjatur (24 orë), vetëm pasi që pajisen me leje pune nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

**8.2 DEPO ME SHUMICË TË ARTIKUJVE USHQIMORË, orari i punës:**

- a) Koha verore prej orës 07:00 – 20:00
- b) Koha dimërore prej orës 07:00 – 19:00

Veprimtaria e përcaktuar me paragrafin 8.2 punon 6 ditë në javë | e diela është ditë pushimi.



### **8.3 DEPO E MATERIALIT NDËRTIMORË orari i punës:**

- a) Koha verore prej orës 07:00 – 19:00
- b) Koha dimërore prej orës 08:00 – 17:00

Veprimtaria e përcaktuar me paragrafin 8.3 punon 6 ditë në javë | e diela është ditë pushimi.

## **Neni 9**

### **VEPRIMTARIT EKONOMIKE TË NDËRTIMTARISË**

#### **9.1 NDËRMARRJET NDËRTIMORE (NDËRTIMI I ULËTË), GURËTHYESIT, XEHERORËT, PRODHUESIT E TULLAVE orari i punës:**

- a) Koha verore, prej orës 07:00 - 18:00.
- b) Koha dimërore, prej orës 08:00 - 17:00

Veprimtaria e përcaktuar me paragrafin 9.1 punon 6 ditë në javë | e diela është ditë pushimi.

#### **9.2 NDËRMARRJET NDËRTIMORE (NDËRTIMI I LARTË), PRODHUESIT E BETONIT, orari i punës:**

- a) Koha verore, prej orës 07:00 - 18:00.
- b) Koha dimërore, prej orës 08:00 - 17:00

Veprimtaria e përcaktuar me paragrafin 9.2 punon 6 ditë në javë | e diela është ditë pushimi.

Ndërmarrjet ndërtimore ( Ndërtimi i lartë dhe i ulët), në raste të nevojshme, për shkak të natyrës së punimeve, mund të punojnë me orar te zgjatur dhe ditëve të dielave, pasi të jenë pajisur me leje ditore me orar shtesë nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

## Neni 10

### VEPRIMTARI EKONOMIKE TË GASTRONOMISË ( RESTORANTE, KAFITERITË DHE SALLA DASMASH)

#### 10.1 RESTORANTE DHE KAFITERI orari i punës:

- a) koha verore prej orës 07:00 – 24:00
- b) koha dimërore prej orës 07:00 – 23:00

Veprimtaritë e përcaktuara me paragrafin 10.1 punojnë 7 ditë në javë.

Në kuadër të predispozitës 10.1 inkorporohen edhe njësit e restoranteve dhe kafiterive që kanë hyrje të veçanta si njësi të integruara të qendrave tregtare.

#### 10.2 SALLAT E DASMAVE :

- a) koha verore prej orës 07:00 – 1:00 të mëngjesit
- b) koha dimërore prej orës 07:00 – 24:00

Veprimtarit e e përcaktuara nga neni 10, paragrafi 10.1 dhe 10.2 munden te punojnë me orar te zgajtur deri ora 3:00, pasi të jenë pajisjen me leje pune nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

## Neni 11

### VEPRIMTARI EKONOMIKE TË HOTELERISË

#### 11.1 HOTELE, MOTELE , HOSTELE , BUJTINA , KAMPE DHE SHËRBIME TJERA akomodimi:

- a) koha verore dhe dimërore punohet 24 orë

Veprimtaritë e përcaktuara me paragrafin 11.1 punojnë 7 ditë në javë.

## **Neni 12**

**12.1 DISKO KLUBET, KAFE BAR,** në territorin e Komunës së Gjilanit mund të punojnë sipas orarit :

- a) koha verore prej orës 20:00 – 24:00
- b) koha dimërore prej orës 19:00 – 23:00

Veprimtaritë e përcaktuara me paragrafin 12.1 punojnë 6 ditë në javë.

Veprimtaritë ekonomike Disko klubet dhe Kafe-bar mund të punojnë Ditën e Diele dhe ditëve të tjera si dhe gjatë festave zyrtare me orar të zgjatur deri në ora 05:00 vetëm pasi që pajisen me leje pune nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

## **Neni 13**

**13.1 VEPRIMTARITË SPORTIVE - REKREATIVE** në territorin e Komunës së Gjilanit mund të punojnë sipas orarit :

- a) koha verore prej orës 8:00 – 24:00
- b) koha dimërore prej orës 8:00 – 23:00

- 3. Për objektet e mbuluara gjatë gjithë vitit vlen orari veror.
- 4. Pishinat e hapura punojnë gjatë sezonit veror me orar 08:00 deri 22:00
- 5. Pishinat e mbyllura lejohet të punojnë deri orën 24:00

Veprimtaritë ekonomike të përcaktuara me paragrafin 13.1 punojnë 7 ditë në javë.

## **Neni 14**

### **TREGJET**

**14.1 TREGU I GJELBËR:** E Hënë – Shtunë nga ora 06:00 deri në orën 20:00.

**14.2 TREGU I KAFSHËVE:** e Shtune nga ora 06:00 deri në orën 16:00.

**14.3 TREGU I AUTOMJETEVE dhe TREGU I RROBAVE TË PËRDORURA:**  
e Shtunë nga ora 06:00 deri në orën 16:00

**14.4 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE METALIT, PIKAT E RICIKLIMIT :** munden të punojnë 7 ditë të javë sipas orarit :

- a) koha verore prej orës 8:00 – 18:00
- b) koha dimërore prej orës 9:00 – 16:00

## **Neni 15**

### **RENDI DHE QETËSIA PUBLIKE DHE MBROJTJE NGA ZHURMA**

15.1 Të gjitha shoqëritë tregtare janë të obliguara që gjatë ushtrimit veprimtarive të tyre ekonomike të mos bien ndesh me Ligjin Nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike dhe Ligjin Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma si dhe akteve tjera nënligjore.

## **Neni 16**

### **LEJE PËR ZGJATJEN E ORARIT TE PUNËS**

16.1 Për orar më të gjatë se orari i punës i paraparë më këtë rregullore shoqëritë tregtare duhet të pajisen me leje pune nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

16.2. Drejtoria për zhvillim Ekonomik është e obliguar që brenda afatit ligjor të shqyrtoj kërkesën dhe të marrë vendim për refuzimin apo aprovimin e kërkesë për zgjatjen e orarit të punës.

16.3 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e mbanë të drejtën për tërheqjen/revokimin e vendimit për zgjatjen e orarit te punës në rast të prishjes se rendit dhe të qetësisë publike apo ankesave të qytetarëve.

## Neni 17

### DOKUMENTE PËR APLIKIMIN PËR ZGJATJEN E ORARIT TË PUNËS

17.1 Me rastin e aplikimit për zgjatjen e orarit të punës shoqëritë tregtare duhet plotësojnë i formularit zyrtar për zgjatjen e orarit, i cili duhet të dorëzohet në Qendrën për Shërbime me Qytetare të Komunës, duke i bashkangjitur :

- kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit,
- kopjen e letërnjoftimit të pronarit dhe
- vendimin e pranimit teknik të lokalit afaristë

## Neni 18

### TARIFAT E PAGESAVE PËR LEJE PËR ZGJATJEN E ORARIT TË PUNËS

18.1 Tarifat për pajisen me leje pune nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik :

18.2 Veprimtarit tregtare të përcaktuara nga :

- nenet 5, paragrafi 5.7,
- nenin 7, paragrafi 7.3,
- nenin 8, paragrafi 8.1,
- nenin 10, paragrafi 10.1 dhe 10.2

Për tu pajisur me leje pune për zgjatje të orarit (ditëve të Diela) duhet të paguajnë çmimin prej (1€) për m<sup>2</sup>, për hapësirat e shfrytëzuara

18.3 Veprimtarit tregtare të Ndërmarrjeve Ndërtimore ( Ndërtimi i ulë dhe lartë), të përcaktuara nga :

- nenin 9, paragrafi 9.1 dhe 9.2

Për zgjatje të orarit të punës dhe (ditëve të Dielave) duhet të paguajnë çmimin prej (30€) për ditë pune.

18.4 Veprimtarit tregtare të përcaktuara nga :

- nenin 12, paragrafi 12.1,

Për tu pajisur me leje pune për zgjatje të orarit (ditëve të Dielave) duhet të paguajnë çmimin prej (1.5€) për m<sup>2</sup>, për hapësirat e shfrytëzuara .

Veprimtarit tregtare / subjektet afariste nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, për hapësirat e shfrytëzuara mund të *pajisen me leje pune minimum (1) muaj dhe maksimum (12) muaj,*

Me dhënien e lejes së punës të lëshuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, subjekti afarist duhet ta sjell *dëshminë e pagesës për zgjatjen e orarit të punës* në përputhje me këtë rregullore.

Me dhënien e lejes së punës të lëshuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik duhet të njoftohet Drejtoria e Inspektionit dhe Policia e Kosovës.

**Neni 19**  
**PROCEDURA E ANKESËS KUNDËR VENDIMIT TË DREJTORISË PËR ZHVILLIM**  
**EKONOMIK**

19.1 Kundër Vendimit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, lejohet ankesa brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditëve kalendarike, e cila i drejtohet Komisioni të Ankesave në Komunën e Gjilanit.

19.2 Ankesa e parashtruar nga pala e pakënaqura kundër vendimit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik nuk e ndalon ekzekutimin e **vendimit**.

19.3 Vendimi i Komisioni është përfundimtar në procedurën administrative.

Pala e pakënaqur mund të inicioi kontest administrativ në Gjykatën kompetente.

**Neni 20**  
**VENDOSJA E SIMBOLEVE SHETËRORE**

20.1 Të gjithë pronarët e shoqërive tregtare të cilat ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Gjilanit janë të detyruara që në lokalet afariste ta respektojnë Ligji Nr. 03/L-038 për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës (Ligj i cili rregullon përdorimin e simboleve shtetërore të Republikës së Kosovës)

20.2 Sipas Neni 4 të Ligjit Nr. 03/L-038 - përdorimi i flamurit të Republikës së Kosovës | flamuri shtetëror vendoset në mjediset e brendshme dhe të jashtme të biznesit.

20.3 Sipas Neni 6 të Ligjit Nr. 03/L-038 - përdorimi i flamujve kombëtarë ka të drejtë të përdorë në pajtim me këtë ligj dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

## **Neni 21**

### **INSPEKTIMI**

21.1 Inspektori komunal kryen inspektimin sipas detyrës zyrtare dhe në bazë të ankesës së palës së tretë.

21.2 Inspektori komunal është i detyruar që të informojë parashtruesin e ankesës (pasi ka bërë ankesë në Qendrën për Shërbime me Qytetare të Komunës) lidhur me gjendjen e konstatuar, respektivisht masat e ndërmarra brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike.

21.3 Inspektori komunal duhet të konstatoj gjendjen faktike me procesverbal, përmes fotove dhe incizimeve dixhitale, faturave/kuponëve fiskal si dhe informatave tjera të besueshme.

21.4 Inspektori në çdo kohë mund të ndaloj përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë dhe mbyll lokalit afarist në të cilin ushtrohet veprimtaria ekonomike në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore.

21.5 Elementet formale-juridike që duhet ti përmbaj akti administrativ që e lëshon inspektori, janë të përcaktuara në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

## **Neni 22**

### **III. DISPOZITAT NDËSHKUESE**

22.1 Në rastet kur konstatohet se janë shkelur dispozitat e kësaj rregullore inspektori i tregut duhet që brenda afatit 8 (tetë) ditësh kalendarike nga dita e konstatimit të shqipton gjobë.

22.2 Gjobat të përcaktuara me këtë rregullore paguhen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e shqiptimit të tyre, por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e shqiptimit të tyre.

22.3 Nëse subjekt i gjobitur bënë pagimin e gjobës të shqiptuar me këtë Rregullore brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, subjekti lirohet nga pagimi i pesëdhjetë për qind (50%) të shumës së gjobës.

22.4 Subjekti të cilit i është shqiptuar gjoba sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje ka të drejtë të paraqes ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit. Ankesa ndaj vendimit i drejtohet komisionit për ankesa të Komunës së Gjilanit.

22.5. Ankesa kundër vendimit të Inspektorit të Tregut nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

## **Neni 23**

### **Gjobat**

**23.1** Të gjitha shoqëritë tregtare që veprojnë në kundërshtim me dispozitat ligjore të kësaj rregullore do të ndëshkohen me gjobë.

**23.2** Shoqëritë tregtare të cilat nuk i përmbahen kësaj rregulloreje do të dënohen me gjobë si në vijim:

**23.2.1** Personat juridik 500 (pesëqind) deri 2.000 (dymijë) €.

**23.2.2** Personat përgjegjës të subjektit juridik 200 (dyqind) deri 1.500.00 (njëmijepesëqind) €.

**23.2.3** Personi fizik gjobitet nga 50 – 300 € .

**23.2.4** Mos vendosja e orarit të kujdestarisë sipas nenit 4 paragrafi 4.1 dhe 4.2 dënohet me gjobë administrative 100 euro deri 200 euro.

**23.3** Mjetet e mbledhura nga këto gjoba derdhen në buxhetin e komunës se Gjilanit

## **IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 24**

#### **MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TE RREGULLORES**

24.1 Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtoria për Inspektion ne koordinim edhe me Institucione tjera (Policia dhe Gjykata)

### **Neni 25**

#### **HARMONIZIMI I ORARIT TE PUNES**

25.1 Të gjitha shoqëritë tregtare janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e tyre të punës me dispozitat e kësaj rregulloreje në afatin prej 30-ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.



## Neni 26

### DISPOZITAT SHFUQIZUESE

26.1 Me hyrje në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr. \_\_\_\_\_, e datës \_\_\_\_\_ (Rregullorja për fillimin dh e mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Gjilanit)

## Neni 27

### HYRJA NË FUQI

27.1 Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

Nr. \_\_\_\_\_  
Gjilan, më \_\_\_\_\_

Kryesuesi i Kuvendit,

\_\_\_\_\_  
Kushtrim Kadriu